



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 496/8 Prot.

Tiranë, më 30 . 11 . 2023

**V E N D I M**

Nr. 240, Datë 30 . 11 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “c”, të LMD, ku përcaktohet se: *“Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”*, si dhe bazuar në informacionin dhe problematikat e transmetuara në emisionin “Fiks Fare” të datës 29.03.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Urdhrin nr. 56, datë 11.04.2023, ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së monitorimit të kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara, në ambientet e godinës së QZHPAK, Vlorë, në Bashkinë Vlorë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se: *“Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”*.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes kryesisht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve bazuar në informacionin e transmetuar në emisionin “Fiks Fare”, datë 29.03.2023, në Tv Top Channel.**

Referuar informacionit të përcjellë në emisionin “Fiks Fare” të datës 29.03.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, ndër të tjera, evidentohen një sërë problematikash, të pasqyruara në reportazhin e filmimit të bërë në ambientet e QZHPAKVlorë, si më poshtë citohet:

*“Në muajin janar të vitit 2022, Fiks Fare denoncoi abuzimet me ndërtimin e godinës së Qendrës së Zhvillimit në Vlorë, ku megjithëse ishin shpenzuar plot 240 milionë lekë të vjetra, sërish ishte*

*e shkatërruar. Në atë godinë qëndrojnë rreth 30 persona, të cilët iu është dashur që të jetojnë në një ambient të papërshtatshëm, krevate të shkatërruar, mungojnë dyer, ka lagështirë, myk apo edhe suva të rëna.*

*Një vit pas këtij denoncimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka evidentuar të njëjtat problematike. Fiksi ka siguruar këtë raport, ku konstatohen probleme të shumta higjieno-sanitare për mbajtjen e ushqimeve si dhe me ndërtimin e godinës.*

*“Konstatohet se ambientet janë në kushte të papërshtatshme për magazinimin e mallrave dhe ushqimeve dhe nuk plotësojnë parametrat higjieno-sanitarë. Ka lagështirë dhe erë të rëndë! Ky magazinim ka shkelur çdo standard ushqimor. Ato janë dërguar në zyrën e magazinieres, disa rifuxho në çimento dhe disa në ambiente akulli në frigorifer. Pulat janë të pa paketuara dhe disa të prishura me erë të rëndë dhe ngjyrë të transformuar” thuhet në këtë raport.”*

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup> është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar<sup>2</sup>, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Në nenin 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

*a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

*2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...*

*c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 496/1 prot., datë 11.04.2023, nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Bashkisë së Vlorës, Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, Vlorë, Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me sqarimin e plotë të çështjes mbi të cilën është iniciuar hetimi kryesisht nga KMD-ja.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me anë të shkresës nr. 1643/1 prot., datë 20.04.2023, ndër të tjera, ka informuar Komisionerin, si më poshtë vijon:

*“Qendra e Zhvillimit PAK Vlorë, është një institucion publik rezidencial për personat me aftësi të kufizuara, në administrim të Bashkisë Vlorë dhe me financim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila përmes Shërbimit Social Shtetëror financon dhe monitoron standardet e ofrimit të shërbimeve në këtë institucion.*

*Mbështetur në Raportin Final të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Auditim financiar dhe i përputhshmërisë të ushtruar në subjektin QZHPAK Vlorë, për periudhën 01.01.2022 deri më 30.06.2022, bazuar në këto rekomandime, u propozua plani i masave, shoqëruar me strukturën përgjegjëse për zbatim, si dhe afatet e zbatimit, sipas shkresës dërguar KLSH-së me nr. Prot., 335/2, datë 07.02.2023.*

*Shërbimi Social Shtetëror është ngarkuar për ngritjen e grupit të punës dhe realizimin e auditimit të subjektit QZHPAK Vlorë, me objekt “Auditimin Financiar dhe të Performancës, bazuar në konstatimet/rekomandimet e lëna nga ekipi auditues i KLSH-së, Qershor 2022”.*

*Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar monitorimin pranë QZHPAK Vlorë, ku janë konstatuar se kushtet higjieno-sanitare dhe ushqimi për përfituesit janë në përputhje me standardet e ofrimit të shërbimeve, në interesin më të lartë të përfituesve”.*

- Njëpërmjet shkresës me nr. 65 prot., datë 18.04.2023, QZHPAK Vlorë/Bashkia Vlorë, ka informuar Komisionerin si më poshtë vijon:

*“Ju bëjmë me dije se, në QZHPAK Vlorë janë akomoduar 30 rezident të moshave nga 12-34 vjeç, nga të cilët 17 janë të braktisur dhe 13 me familje.*

*Lidhur me problematikat e evidentuara nga emisioni “Fiks Fare” dhe më pas edhe KLSH-ja, ju bëjmë me dije se, periudha në të cilën ka audituar KLSH-ja, përkonte me tenderimin e dytë të bërë nga UNDP për rregullimin dhe sisteminim e problematikave të dala nga dështimi i investimit të mëparshëm, arsye për të cilën godina nuk është marrë në dorëzim nga ana jonë.*

*Gjatë investimit të dytë, është eliminuar pothuajse fare lagështia. Kështu që, për pasojë jo vetëm në magazinë, por në të gjithë institucionin era e lagështirës e cila vinte si pasojë e qëndrimit pezull të ujrave të zeza, nuk ekziston më, pasi është ndërhyrë në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza si dhe drenazhimin tej për tej të institucionit. Është bërë suvatimi me rrjetë deri në nivelin e dritares, janë vendosur dyer të reja, janë kryer instalime të reja dhe lyerje si pasojë e punimeve për eliminimin e lagështirës.”*

QZHPAK Vlorë ka depozituar në cilësi prove pranë KMD-së, kopje të dokumentacionit ku evidentohen masat e marra prej tyre, kopje të Raportit të KLSH-së, Akt-Inspektimeve e konstatimeve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU-së) dhe Inspektoriatit Shtetëror të Shëndetësisë (ISHSH-së), dokumentacion tek i cili Komisioneri është referuar në arsyetimin e analizimin e fakteve e provave, gjatë vendimit të tij (Pjesa III e vendimit).

Njëpërmjet shkresës me nr. 16 prot., datë 01.02.2021, me lëndë: *“Informacion mbi problematikat e Projektit të realizuar nga UNDP në QZHPAK Vlorë”*, (depozituar si dokument bashkëlidhur parashtrimeve me shkresën me nr. 65 prot., datë 18.04.2023, të QZHPAK Vlorë/Bashkia Vlorë) evidentohet se QZHPAK Vlorë, i është drejtuar Bashkisë Vlorë, duke e informuar si më poshtë vijon:

*“Bazuar në nevojat e QZHPAK Vlorë, janë bërë dy ndërhyrje madhore në infrastrukturën e kësaj Qendre, të financuara nga UNDP. Konkretisht, faza e parë e punimeve, konsistonte në rikonstrukcionin e tualeteve dhe eliminimin e lagështirës nëpërmjet drenazhimit të objektit, si dhe vendosja e ashensorit për të lehtësuar lëvizjen e rezidentëve.*

*Projekti/faza e dytë përfshinte rikonstrukcion total të të gjithë godinës, me qëllim rikonceptimin e kësaj Qendre, jo vetëm rezidenciale por edhe funksionimin e saj si një qendër ditore.*

*Për këtë, të gjitha mjediset si: dhoma gjumi, dhoma ndenje, atelie, u zhvendosën në katin e dytë të ndërtesës, në funksion të rezidentëve. Në katin e parë të godinës u organizuan të gjitha zyrat e terapive, me qëllim shërbimim rezidencial dhe komunitar. Rikonstruksioni përfshinte zëvendësimin e dypeve, dritareve, sistemin kapot dhe fasada të jashtme, izolimi i tarracës, suvatime, shtrim pllakash si dhe mundësimi i bazës materiale për sallat e terapive, zyrat e administratës dhe minikuzhinave.*

*Për këtë arsye, gjithë stafi dhe rezidentët janë akomoduar pranë mjediseve të kopshtit “Pulëbardhat”, deri në përfundim të punimeve.*

*Hyrja në institucon u realizua, pasi në çdo aspekt i rindërtimit dukej vizualisht i rregullt. Problemet e para filluan të evidentoheshin shumë shpejt me nisjen e shirave sezonalë. Lagështia u bë shumë e evidente, jo vetëm në vendet e mëparshme, por në të gjithë zonat e tubave të shkarkimit, mjediset e brendshme dhe tavanet e katit të parë.*

*Përsa i përket dypeve të brendshme, materiali i tyre ishte tërësisht karton, i cili sapo ra në kontakt me avujt e dypeve, u shpërbë. Kasat dhe fashetat e dypeve ranë shumë shpejt pasi nuk ishin të lidhura, menteshat dilnin dhe të gjitha dyert shkëputeshin duke rrezikuar jetën e rezidentëve. Për pasojë, ne i grumbulluam të gjitha dyert në një mjedis.*

*Përsa i përket instalimeve elektrike, mund të themi se linja nuk mban ngarkesën elektrike të nevojshme nga Institucioni për funksionimin e pajisjeve minimale.*

*Aktualisht nuk na është mundur asnjë plan projekt i rrjetit elektrik, në mënyrë që të kemi mundësi të ndërhyjmë për defektet e mundshme. Për pasojë, të gjithë çelësat e kuadrit janë djegur dhe janë zëvendësuar prej nesh.*

*Për shkak të ndërhyrjeve në linjën elektrike, murit të ngopur me lagështi, i cili ra në shumicën e Institucionit, jemi të detyruar të kryejmë vetë punime lryerjeje nga vetë punonjësit.*

*Janë vënë re defekte në sistemin hidraulik, ku tubacionet janë shkëputur dhe ujërat në njërin prej lavamanëve të minikuzhinës në katin e dytë, shkarkohen në katin e parë.*

*Vlen të theksohet që, me hyrjen në Institucion, që prej muajit gusht deri në dhjetor 2020, Institucioni ynë ka qenë në kushte karantinimi duke penguar evidentimin dhe ndërhyrjet në kohë në problematikat e evidentuara.*

*Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me UNDP, konkretisht inxhinieren Gj. B, administratorin e firmës AGE Co&Co Construction, si dhe me Drejtorin e punimeve B. R, lidhur me gjendjen e Institucionit dhe zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve difektoze dhe mungesave në Qendër.*

*Pas kontaktimit të vazhdueshëm dhe ndërhyrjes së Bashkisë Vlorë, është bërë i mundur ndërtimi i një kanali kullues, i cili lidh drenazhimin me kanalin e ujërave sipërfaqësore. Ky kanal është mundësuar nga Ujësjellës Kanalizime, Vlorë.*

*Aktualisht, na është premtuar zëvendësimi i dyerve të Qendrës nga UNDP.*

*Lagështia në Institucion vazhdon të jetë prezente dhe më e agravuar, e shfaqur pothuajse në të gjitha mjediset duke paraqitur erë të rëndë, pasi vjen si pasojë e lagështirës nga ujërat e zeza. Instalimet elektrike vazhdojnë të paraqesin probleme.*

*Së fundmi, mund të themi që financimi, plan projekti, prokurimi, firma kontraktuese, supervizimi i gjithë këtij procesi është bërë nga UNDP.”*

2. Në vijim të hapave proceduralë, lidhur me shqyrtimin e hetimin e problematikës në fjalë, me Urdhrin me nr. 122, datë 25.08.2023, Komisioneri, bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja c) e LMD-së, ka urdhëruar të realizohet inspektimi në godinën e QZHPAK Vlorë, me qëllim këqyrjen e verifikimin e situatës në vend<sup>3</sup>.

Me datë 21.09.2023, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë godinës së QZHPAK Vlorë, dhe u takuan me Drejtorin e kësaj Qendre, E. G, e cila ishte e pranishme gjatë gjithë inspektimit të kryer.

Në Qendër janë të akomoduar gjithsej 30 rezident, të moshave nga 12 vjeç-34 vjeç, nga të cilët 12 vajza dhe 18 djem, dhe nga këto 6 janë të moshës 12-18 vjeç, 6 janë të moshës deri në 21 vjeç dhe të tjerët mbi 21 vjeç.

Stafi i punësuar në QZHPAK Vlorë përbëhet prej 31 punonjësish: Drejtorja, 1 (një) financier, 1 (një) punonjëse sociale, 1 (një) fizioterapist, 7 (shtatë) edukatore specialiste, 4 (katër) sanitare, 9 (nëntë) kujdestare, 2 (dy) kuzhinierë, 1 (një) infermiere, 1 (një) mjek part-time, 1 (një) logopedist, 1 (një) metodist-edukator, 1 (një) mirëmbajtës-shofer.

Drejtorja e Qendrës theksoi se pamjet e transmetuara nga emisioni Fiks Fare, kishin të bënin me problematika të dala në pah pas përfundimit të rikonstruksionit të bërë në ambientet e Qendrës,

---

<sup>3</sup> Sipas Urdhrit të Inspektimit: “Objekti i inspektimit është këqyrja dhe verifikimi në vend i problematikës kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar, në ambientet e godinës së Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, Vlorë, në Bashkinë Vlorë;

- Verifikimi i kushteve fizike të ambienteve të godinës, ku akomodohen PAK;
- Verifikimi i kushteve higjieno-sanitare të ambienteve të brendshme të godinës;
- Verifikimi i kushteve higjieno-sanitare të ambienteve të mbajtjes së mallrave e produkteve ushqimore;
- Njohja me materiale apo akte të tjera konstatimi të organeve të tjera shtetërore që disponohen nga Qendra e Zhvillimit për PAK, Vlorë, që lidhen me verifikimin e kushteve fizike dhe higjieno-sanitare të godinës dhe ambienteve të brendshme të saj;
- Si dhe çdo verifikim tjetër që lind i nevojshëm gjatë inspektimit dhe ka lidhje me objektin e çështjes në hetim administrative pranë KMD-së.”



në gusht 2020, punime të cilat janë realizuar nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) në kuadër të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Vlorë (MM 9832/2019).

Si rezultat i evidentimit të gjithë problematikave sipërcituar, Drejtorja e QZHPAK Vlorë, pas përfundimit të punimeve të kryera për rikonstruksionin e Qendrës, megjithë kërkesat e vazhdueshme të PNUD-it për dorëzimin e objektit, nuk ka pranuar për ta marrë në dorëzim, pikërisht për shkak të këtyre problematikave të theksuara, për të cilat kishin vënë në dijeni edhe Bashkinë Vlorë<sup>4</sup>.

Më pas, Drejtorja e Qendrës, evidentoi faktin se, pas konstatimit të të gjithë problematikave të paraqitura, dhe përcjelljes së tyre tek PNUD-i dhe organet eprore të saj, u bë një tenderim i dytë, nga PNUD-i për rregullimin e sistemimin e problematikave të dala nga dështimi i investimit të mëparshëm të tyre, dhe aktualisht situata është krejtësisht e përmirësuar.

Referuar të dhënave dhe informacionit të procesverbalit të mbajtur gjatë inspektimit në QZHPAK Vlorë, në përmbushje të objektit të inspektimit/objekt dhe i çështjes së iniciuar kryesisht nga KMD, evidentohet se nga këqyrja e verifikimi në terren i ambienteve të kësaj godine, situata në Qendër, rezulton si më poshtë citojmë:

- Krahasimisht me pamjet e ambienteve të brendshme të godinës, të transmetuara në emisionin “Fiks Fare”, të datës 29.03.2023, pamja aktuale e këtyre ambienteve të godinës, me sy të lirë rezulton e përmirësuar në mënyrë të dukshme. Pamjet janë dokumentuar me foto nga inspektorët e KMD-së, janë depozituar në dosje në cilësi prove.
- Godina ka dy kate. Zyrat, korridoret dhe ambientet e tjera të vendosura në *katin e parë*, janë të gjitha të rikonstruara dhe përbëhen nga:
  - Zyra e Punonjësit Social ;
  - Zyra e Fizioterapistit;
  - Zyra e Aktiviteteve;
  - Zyra e Logopedistit;
  - 3 (tri) salla të dedikuara për terapi zhvillimi;
  - 5 (pesë) tualete + tualet me dush;
  - 2 (dy) Magazina rrobash (njëra dedikuar për rrobat e dimrit dhe tjetra për rrobat e verës);
  - 1 (një) Lavanderi;
  - Magazina e Ushqimeve;
  - Kuzhina;
  - Menca;
  - 1 (një) Magazinë detergjentësh;

---

<sup>4</sup> Referuar shkresës me nr. 16 prot., datë 01.02.2021, me lëndë: “Informacion mbi problematikat e Projektit të realizuar nga UNDP në QZHPAK Vlorë”.

- Zyra e Drejtorit;

Të gjitha ambientet e katit të parë të godinës së QZHPAK Vlorë, janë të rikonstruara, dhe në pamje të parë, me sy të lirë vërehen elementë të rregullt të çdo dhome/zyre/ambienti, përfshirë ndriçimin, dyer e dritare të rregullta, mobilim i duhur dhe i rregullt, ambiente të përshtatshme dhe të dedikuara sipas secilit aktivitet e specifikë për të cilën funksionojnë si të tilla.

Ambientet e *katit të dytë*, kryesisht janë ambientet e fjetjes, të vendosura në dy korridore të gjata përballë njëra-tjetrës, ku në njërin anë janë ambientet e fjetjes për vajzat dhe në tjetrën ato për djemtë.

Ambientet e fjetjes të vajzave përbëhen nga 7 dhoma (teke, dyshe dhe treshe, me hapësira të mjaftueshme secila). Secila dhomë është e pajisur me kondicioner, krevatë, dollapë, komedinë, jane të sistemuara dhe me ndriçim natyral. Të gjitha pajisjet/mobiliet janë të reja dhe të përshtatshme për dhomat. Muret janë të lyera, të pastra dhe të pikturuara me emra të personalizuar të rezidentëve që flenë aty.

Në korridorin e ambienteve të fjetjes së vajzave, ndodhet një tualet dhe dush, një minikuzhinë dhe një Atelie për punimet me dorë të realizuara nga rezidentët.

Të gjitha ambientet janë të rikonstruara, të pastra, të rregullta, të ndriçuara, dhe me mobilim të përshtatshëm e funksional për qëllimin për të cilin janë konceptuar.

Ambientet e fjetjes të djemve përbëhen nga 6 dhoma (dyshe dhe treshe-me hapësira të mjaftueshme secila dhe me të njëjtin standard si dhomat e vajzave.)

Secila dhomë është e pajisur me kondicioner, krevatë, dollapë, komedinë, jane të sistemuara dhe me ndriçim natyral. Të gjitha pajisjet/mobiliet janë të reja dhe të përshtatshme për dhomat. Muret janë të lyera, të pastra dhe të pikturuara me emra të personalizuar të rezidentëve që flenë aty.

Edhe në korridorin e ambienteve të fjetjes së djemve, ndodhet një tualet dhe dush, një minikuzhinë dhe një Atelie.

Në të gjitha ambientet e katit të dytë të godinës së QZHPAK Vlorë nuk evidentohet asnjë problematikë.

U konstatua se në katin e parë kishte një ashensor, për të cilin drejtorja e Qendrës informoi se momentalisht ishte jashtë funksionit, dhe për këtë arsye nuk ishte marrë në dorëzim prej saj, dhe se aktualisht puna për vënien në funksionalitet të tij, konfrom rregullave e standardeve të miratuara teknike/ligjore, po vijon në bashkëpunim me Bashkinë e Vlorës, në përmbushje të rekomandimeve të bëra nga ISHPSHSH.

### **III. Kuadri ligjor i zbatueshëm.**



Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike. Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

## Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

### Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

### Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.
2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

### Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

### Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

*“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj, Kushtetuta ka parshikuar se:

*“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:*

*e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;*

*f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor<sup>5</sup>.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

*“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...”*

<sup>55</sup> Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

2. *Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...*

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “*a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>6</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>7</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>8</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në

<sup>6</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>7</sup> Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>8</sup>Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

përpjekje për të korigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>9</sup>.

Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të, që prej 11 Shkurtit 2013.

Kjo Konventë, në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se:

*“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”*

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), ka për qëllim të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: *“Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar”* ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

- “(a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;*
- (b) Mosdiskriminimin;*
- (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;*
- (d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;*
- (e) Mundësi të barabarta;*
- (f) Akses; ...”*

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

*“1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.*

---

<sup>9</sup> Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.

3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm.

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.”

KDPAK parashikon në nenin 9, të saj, të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. Neni 9, i KDPAK vendos mbi shtetet detyrimin për të marrë masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët.

Në nenin 29, shkronjën a), të Konventës, përcaktohet se:

“Shtetet Palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër: a) T'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët....”.

Për të siguruar këtë të drejtë, KDPAK, ngarkon shtetet me disa detyrime, ndër të tjera, për të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë akses në institucionet apo shërbimet e ofruara për publikun.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të së drejtës, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa “Për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara” bazohet jo më në modelin e “bamirësisë”, por në atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuar, si të gjithë qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por barrierat që vendos shteti apo shoqëria, duke penguar gëzimin e tyre. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave

fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se:

“9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.”

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se:

“ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesja e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë aksesin në të gjitha shërbimet publike.

Realizimi progresiv do të thotë që heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:



“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshëm është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se:

“...duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar<sup>10</sup> dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar<sup>11</sup>.”

Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Ligji nr. 93/2014, i ndryshuar, ka për qëllim:

“a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

<sup>10</sup> Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

<sup>11</sup> Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.



- a) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”.

Në kuptim të këtij ligji. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjimit të pengesave të të gjitha llojeve.

*Jetesa e pavarur*, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se:

“Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës”.

Sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.93/2014, parashikohet: “ 2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës;...”

Në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet se:

“1. *Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.*”

Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshyuar

Neni 1

“Objekti”

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore,

predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër

Neni 2

“Qëllimi”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

“Përkufizimet”

1. “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Neni 20

“Të mirat dhe shërbimet”

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Neni 22

“Statusi”

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

“Kompetencat”

1. Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje

të këtij ligji;

...ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislationit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislationit ekzistues;

Ligji nr. 121/2016 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*, ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ky Ligj thekson rëndësinë e shërbimeve komunitare për të përmbushur nevojat e anëtarëve të komunitetit, me karakteristika të veçanta, që i bën ata më vulnerabël në raport me qytetarët e tjerë.

Ligji nr. 121/2016, *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*, ka përcaktuar rolin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (neni 31) si përgjegjëse për përcaktimin e politikave, standardeve minimale të shërbimeve, kritereve dhe kushteve që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, këshillimin dhe udhëzimin e bashkive për planifikimin e shërbimeve dhe strukturat përgjegjëse, si dhe planifikimin e nevojave për financim të shërbimeve nga buxheti i shtetit.

Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror frymëzohen nga parimet themelore që përshkojnë kujdesin shoqëror, siç janë: parimi i interesit më të lartë të fëmijës; parimi i garantimit të vlerave dhe personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfituar; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; decentralizimi; pavarësia; integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit.

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Shërbime të kujdesit shoqëror” është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

“Shërbime rezidenciale” janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.

“Person me aftësi të kufizuar” është individ, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në këtë Ligj, ndër të tjera, janë:

- 1.Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve.
2. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë:

- a) shërbimet parashoqërore;
- b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;
- c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;
- ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjence;
- d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;
- dh) shërbimet e specializuara;
- e) shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

3. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.

Në shërbimet shoqërore publike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.

Neni 21, i këtij Ligji, Shërbimet në qendrat rezidenciale, parashikon se:

1. Shërbime në qendrat rezidenciale konsiderohen shërbimet e strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohet kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur.
2. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit.

Neni 22, Strehimi afatgjatë

1. Strehimi afatgjatë u sigurohet individëve që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore, kur ky kujdes nuk u sigurohet dot në familje apo familje kujdestare.
2. Personat që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm janë:
  - a) personat me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje, duke i dhënë format e duhura institucionale të kujdesit;
  - b) të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

Ligji 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ngarkoi njësitë e pushtetit vendor me një gamë të gjerë përgjegjësish dhe funksionesh të reja, përfshirë ato në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror që lidhen me identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e masave për plotësimin e nevojave të komunitetit, në përgjithësi dhe grupeve në nevojë, në veçanti.

Në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, *“Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 *“Për strehimin social”* dhe VKM-së me nr. 839, datë 03.12.2014, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në*

*institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror për PAK*”; në institucionet e përkujdesit shoqëror pranohen persona me aftësi të kufizuara: a) mendore; b) fizike; c) shqisore.

Me vendimin nr. 276, datë 12.05.2021, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025<sup>12</sup>”.

“Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2021–2025”, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritimit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit, duke pasur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK-së përmes masave specifike.

Pika 3.5.2, e PKVPAK, përcakton se:

*“Gjatë viteve të fundit MSHMS-ja ka punuar në drejtim të një reforme të shërbimeve shoqërore, duke synuar drejt krijimit të shërbimeve të integruara në nivel qendror dhe lokal. Sipas ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, sistemi i menaxhimit dhe referimit për shërbimet sociale për grupin e synuar, garanton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, për të përfutur shërbime. Bazuar mbi këtë ligj është miratuar VKM-në nr. 518/2018, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat, kriteret për përfitimimin e tyre për përfituesit e shërbime sociale”.*

Objektivi kryesor i punës së Qendrave të Zhvillimit është i përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të standardeve të miratuara nga MSHMS, ku hartimi i Standardeve të shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për personat me aftësi të kufizuara është një hap i rëndësishëm në procesin e zbatimit të objektivave për rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale për grupet në nevojë.

Standartet janë parime të përgjithshme që shërbejnë për të siguruar cilësinë e shërbimeve shoqërore. Ato përfaqësojnë një nivel të përbashkët të funksionimit dhe të kryerjes së veprimtarisë, që kërkohet të arrihet nga të gjithë llojet e shërbimeve shoqërore<sup>13</sup>.

Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale monitoron institucionet e përkujdesit social rezidencial, jo rezidencial, publik dhe privat për plotësimin e standarteve të miratuara, ndër të cilat edhe:

- Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Institucionet Rezidenciale

<sup>12</sup> [https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-2021-2025\\_AL.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-2021-2025_AL.pdf)

<sup>13</sup> <https://www.sherbimisocial.gov.al/standartet-per-sherbimet-shoqerore/>

- Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për Persona me Aftësi të Kufizuar në Institucionet Rezidenciale dhe Ditore.

Bazuar në VKM nr. 822, datë 06.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”, standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara, synojnë respektimin e parimeve të dokumenteve themelore, si: parimi i së drejtës civile, barazisë dhe mosdiskriminimit, i vetëvendosjes, i përfshirjes, i pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta, i jetesës pa barriera dhe mjedisit të lirë, i rehabilitimit, parandalimit, identifikimit dhe trajtimit të hershëm të aftësisë së kufizuar, integritit shoqëror dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit.

Ky Vendim cilëson ndër të tjera se:

“Vendosja e standardeve të shërbimeve, për personat me aftësi të kufizuara, do të garantojë dhe zhvillojë:

Ushtrimin e të drejtave dhe lirive të PAK të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë, zbatimin e legjislacionit vendas dhe detyrimeve të konventave të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Europës, të ratifikuara nga Parlamenti.

Standardet shërbejnë për të matur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Në kushtet e zhvillimit të shërbimeve publike dhe jopublike, në qendra rezidenciale dhe ditore, të ofruara nga sektori publik, privat dhe OJF-të, shteti nëpërmjet standardeve do të vendosë rregulla dhe kritere për të matur cilësinë e shërbimeve. Këto rregulla janë të detyrueshme për t’u respektuar nga të gjithë ofruesit e shërbimeve, publike dhe private.

Vendosja e standardeve do të ndihmojë strukturat sociale të qarqeve, bashkive dhe komunave për të përmbushur funksionet e reja në kuadër të procesit të decentralizimit. Një nga funksionet e decentralizuara është plotësimi i nevojave sociale të komunitetit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, si një grup në nevojë për shërbime. Adresimi i nevojave me shërbime përfshin identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, planifikimin, ngritjen dhe menaxhimin e shërbimeve, si dhe zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit në nivel rajonal apo lokal.

Reformimi i sistemit të përkujdesit shoqëror, ndër të tjera, synon: sigurimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, barazinë e mundësive dhe akses të barabartë në shërbimet sociale. Për t’iu përgjigjur më mirë nevojave sociale në rritje të PAK, është e nevojshme të rritet përgjegjësia jo vetëm e njësisë të qeverisjes vendore, por e gjithë komunitetit dhe angazhimi i sa më shumë aktorëve dhe burimeve në shërbimet shoqërore.

Sipas Vendimit nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale<sup>14</sup>”, standardet janë konceptuar si standarde të cilësisë,

<sup>14</sup>[https://inspektoriaipunes.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/akt-4-Vendim-i-KM\\_659\\_17.10.2005\\_STANDARTET-QENDRAT-REZIDENCIALE-PER-FEMIJE.pdf](https://inspektoriaipunes.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/akt-4-Vendim-i-KM_659_17.10.2005_STANDARTET-QENDRAT-REZIDENCIALE-PER-FEMIJE.pdf)

në kuptimin që ato do të përdoren si mjet për të arritur dhe njëkohësisht për të vlerësuar cilësinë e shërbimit që ofrohet për fëmijët që rriten në institucionet rezidenciale, jashtë familjeve të tyre biologjike.

Në tabelën referuese, bashkëlidhur këtij Vendimi, ndër të tjera, cilësohet se:

*“Shtëpia siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikpritës, të një stili i shtëpiak dhe të një cilësie të mirë për fëmijët, stafin, prindërit apo personat e tjerë të interesuar, në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj. Shtëpia mbahet në rregull.*

*Shtëpia zbkurohet dhe mobilohet për të krijuar një mjedis të këndshëm shtëpiak të përshtatshëm për numrin, gjininë dhe moshën e fëmijëve që strehohen atje.*

*Shtëpia ku jetojnë fëmijët është një vend i sigurtë.*

*Nuk ka me tepër se 6 fëmije në dhomën e gjumit. Në dhoma fëmijët kane një shtrat dhe pajisje shtrati të përshtatshme, vend për të ndenjtur (për tu ulur), perde, apo mbulesa të tjera dritaresh, ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar, tapet dhe mbulesa të tjera të përshtatshme dyshemeje si edhe ngrohje. Fëmijët kane, dollapë për vendosjen e rrobave, që mund të mbyllet apo ndryshe vend të sigurtë të depozimit të gjerave të tyre personale.*

*Në ndarjen e fëmijëve në dhomat e gjumit merret parasysh mundësia për sjellje abuzive.*

*Fëmijët janë të afte dhe inkurajohen të personalizojnë dhomat e tyre të gjumit.*

*Ekziston një dallim midis hapësirës private dhe të përgjithshme të banimit në shtëpinë në fjalë.*

*Ka dhoma ku fëmijët mund të takohen privatisht me vizitore si edhe hapësira për aktivitete private, për të luajtur, për të pushuar, të cilat nuk prekin aktivitetet e tjera të fëmijëve.*

.....

*Tregohet kujdes që fëmijët të jetojnë në mjedise të pastra, të lyera këndshëm dhe në njësi të vogla tip familjesh edhe pse shtëpia mund të jetë e madhe.*

*Dritaret, prizat janë të sigurtë për fëmijët.*

*Fëmijët janë nëpër dhoma me fëmijë të të njëjtës moshë dhe gjini.*

*Hapësira e tyre personale zbkurohet sipas dëshirës së fëmijëve me një lodër,*

*Ka ndarje ndërmjet hapësirave që përdoren si dhoma gjumi, kuzhinës, dhomës së ngrënies, dhomës së studimit, lavaxerisë, dhomës ku fëmijët qëndrojnë dhe luajnë së bashku, banjovë.”*

VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”,* ka në objekt të saj përcakimin e kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.



Fusha e aplikimit të saj shtrihet në: “...të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit; ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes; ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik”.

Neni 3, i kësaj VKM, ka përcaktuar se “barrierat arkitektonike” janë:

“1...a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;

2. Personat me aftësi të kufizuara (PAK) janë individët, me kufizim të aftësive në lëvizje, si pasojë e dëmtimeve fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

6. Mjet ndihmës për lëvizje është karroca për PAK, shkopi, paterica dhe mjete të tjera ndihmëse për ecje;

8. Eliminimi i barrierave është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

9. Elementet e eliminimit të barrierave janë pjesë të objekteve ndërtimore ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares...”

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave, ka miratuar vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të pengojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c)

*mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar .*

Sipas pikës 2, të Kreut 2, të VKM nr. 1074/2015, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në Vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008/Rregullorja). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

### *“Pjesa I*

*Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike .*

### *Kreu I “Të përgjithshme”*

#### *Neni 1*

*Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit*

*1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.*

*2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*

*3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:*

*- të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*- godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;*

*- ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;*

*- ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.*

#### *Neni 2*

*Përshtatja e objekteve ekzistuese*

*1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe te llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.*

2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.

3. Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.

4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

Neni 3

.....

4. Ky vendim e shtrin zbatimin mbi: a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët; c) mjetet e transportit publik; ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

5. Standardet e përshtatshmërisë zbatohen në të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore ekzistuese si dhe në parqet, sheshet e rrugët ekzistuese, bazuar në kërkesat e parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

.....

8. "Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

9. Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimor ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira dhe pajisje ËC, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi.

Qëllimi i përbashkët i këtyre akteve ligjore dhe nënligjore sipërcituar, është që, nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e PAK (fëmijë dhe të rritur) për trajtim dinjitoz dhe në interesin e tyre më të lartë, në fushën e të mira dhe shërbimeve.

QZHPAK Vlorë, është një institucion rezidencial shtetëror me varësi të dyfishtë: të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, si dhe të Bashkisë Vlorë. QZHPAK ka një kapacitet prej 24 personash, aktualisht në këtë qendër marrin shërbim 31 rezidentë të cilët janë jetim social dhe biologjik dhe vuajnë prej sindromave të ndryshme, ku në të shumtën e rasteve ka një mbivendosje të paaftësive fizike, sensore dhe mendore. Kjo qendër ofron shërbim 24 orë për rezidentët. Në Qendër ofrohen kryesisht shërbimet që vijojnë: Përkujdes Shëndetësor, higjenosanitar, ushqyerje, duke i kushtuar rëndësi të veçantë elementëve të mësimin special, terapive individuale edukative dhe në grup, integrimi social në komunitet, etj<sup>15</sup>.

***Bazuar në parashikimet ligjore sa më sipër, analizën e situatës faktike, të kushteve fizike të godinës dhe mjediseve të brendshme të QZHPAK Vlorë, kronologjinë e ngjarjeve dhe fakteve, si dhe në këqyrjen e dokumentacionit provues, rezulton se:***

Pamjet e transmetuara në emisionin “Fiks Fare”, të datës 29.03.2023<sup>16</sup>, në televizionin Top Channel, pasqyronin një realitet shqetësues sa i përket gjendjes në të cilën ndodheshin ambientet e QZHPAK Vlorë, ku qartazi shquhej ambienti i brendshëm tërësisht i papërshtatshëm, krevate të shkatërruar, mungesë dyersh, lagështirë, myk apo edhe suva të rena.

Nga pamjet e transmetura evidentohen probleme të shumta higjieno-sanitare për mbajtjen e ushqimeve. Drejtuesit e emisionit shprehen gjatë transmetimit të emisionit se:

*“Konstatohet se ambientet janë në kushte të papërshtatshme për magazinimin e mallrave dhe ushqimeve dhe nuk plotësojnë parametrat higjieno-sanitarë. Ka lagështirë dhe erë të rëndë. Ky magazinim ka shkelur çdo standard ushqimor. Ato janë dërguar në zyrën e magazinieres, disa rifuxho në çimento dhe disa në ambiente akulli në frigorifer. ”*

Bazuar në informacionin dhe problematikat e ritransmetuara në këtë emision, Komisioneri, me Urdhrin nr. 56, datë 11.04.2023, ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së monitorimit të kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara, në ambientet e godinës së Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, Vlorë, në Bashkinë Vlorë.

Situata e mësipërme e pasqyruar në transmetimin televiziv të datës 29.03.2023<sup>17</sup>, cilësohet si problematike edhe në gjetjet e bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), gjetje të cituara edhe në emision nga ana e prezantuesve të tij, të cilat i referohen dokumentit të KLSH-së, shkresës me nr. 695/11 prot., datë 19.01.2023.

*“Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet, për QZHPAK Vlorë”*, i KLSH-së, ndër të tjera, lidhur me gjendjen fizike dhe kushtet e brendshme ambientale të godinës së Qendrës, citon se:

<sup>15</sup> <https://sherbimet-per-pak-al.jimdofree.com/qendra-e-zhvillimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-vlore/>

<sup>16</sup> <https://top-channel.tv/2023/03/29/fiks-fare-myk-lageshtire-ushqime-te-prishura-ku-qendrojne-dhe-cfare-hane-personat-me-aftesi-ndryshe-ne-vlore/>

<sup>17</sup> Lidhur me filmimet e një viti më pare, në muajin janar 2022.

*“Nga auditimi financiar dhe përputhshmërisë së ushtruar në subjektin QZHPAK Vlorë, për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 30.06.2022.*

*...Nga auditimi i gjendjes së magazinave konstatohet se ambientet janë në kushte të papërshtatshme për magazinimin e mallrave dhe ushqimeve dhe nuk plotësojnë parametrat higjiëno-sanitare.*

*Nga auditimi i gjendjes së magazinave konstatohet se ambientet janë në kushte të papërshtatshme për magazinimin e mallrave dhe ushqimeve dhe nuk plotësojnë parametrat higjiëno-sanitare, magazine e materialeve të ndryshme pastrimi si detergjentë, pluhur larës, pampersa, etj, është në kushte të papërshtatshme ku konstatohet lagështi e konsiderueshme, erë e rëndë, etj. Po kështu në magazinën e mallrave ushqimorë, artikuj të ndryshëm ushqimorë janë magazinuar në kushte tejet të këqija higjiëno-sanitare, duke shkelur çdo standard ushqimor, duke u lënë rifuxhio në dysheme dhe disa në ambiente akulli në frigorifer.”*

Të gjitha problematikat e evidentuara më sipër, janë problematika të dala në pah pas përfundimit të rikonstruksionit të bërë në ambientet e Qendrës, në gusht 2020, punime të cilat janë realizuar nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) në kuadër të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Vlorë (MM 9832/2019).

Gjithë stafi dhe rezidentët janë akomoduar pranë mjediseve të kopshtit “Pulëbardhat”, deri në përfundim të punimeve nga data 30.06.2020 deri në datën 01.08.2020.

Me hyrjen në Institucion, që prej muajit gusht deri në dhjetor 2020, Qendra ka qenë në kushte karantinimi duke përguar evidentimin dhe ndërhyrjet në kohë në problematikat e evidentuara.

Si rezultat i evidentimit të gjithë problematikave sipërcituar, Drejtorja e QZHPAK Vlorë, pas përfundimit të punimeve të kryera për rikonstruksionin e Qendrës, megjithë kërkesat e vazhdueshme të PNUD-it për dorëzimin e objektit, nuk ka pranuar për ta marrë në dorëzim, pikërisht për shkak të këtyre problematikave të theksuara, evidentuar si më sipër cituar, për të cilat kishin vënë në dijeni edhe Bashkinë Vlorë<sup>18</sup>.

Konstatohet se problematikat e evidentuarar nga emisioni Fiks-Fare (mbi indiciet e të cilit Komisioneri inicioi hetimin kryesisht të tyre) dhe më pas edhe nga Raporti Final i KLSH-së, përkojnë me periudhën e tenderimit të dytë të bërë nga PNUD-i për rregullimin e sistemimin e problematikave të dala nga dështimi i investimit të mëparshëm të tyre, arsye për të cilën nuk u mor në dorëzim godina nga QZH PAK Vlorë.

Duhet theksuar se gjatë investimit të dytë (i cili përkon edhe me momentin kur KMD, ka filluar hetimin kryesisht të këtyre problematikave të evidentuara në emisionin Fiks Fare të Top

<sup>18</sup> Referuar shkresës me nr. 16 prot., dat ë 01.02.2021, me lëndë: “Informacion mbi problematikat e Projektit të realizuar nga UNDP në QZHPAK Vlorë”.

Channel), nga ana e QZHPAK/ Bashkia Vlorë, janë marrë të gjitha masat për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja dhe përmirësimin tërësor të situatës së paraqitur, fakt i pasqyruar në aktet shkresore të institucioneve inspektuese (kryesisht gjatë muajit prill 2023 e në vijim) si dhe konstatuar nga këqyrja në terren e inspektorëve të KMD-së, në ambientet e godinës së QZHPAK Vlorë.

Kështu:

- Nga këqyrja në terren dhe verifikimet e inspektorëve të KMD-së, dhe po ashtu inspektimet e autoriteteve përgjegjëse si: Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqëqyrjes së Tregut (ISHMT), Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), (respektivisht autoriteteve qendrore e rajonale të tyre), konstatohet se: lagështira në ambientet e godinës është eliminuar pothuajse në masën 100%. Po ashtu kushtet fizike të ambienteve të brendshme të godinës (dhoma gjumi, ambiente ndenjeje, argëtimi, ambientet e mësimi, fizioterapisë, ambientet e ngrënies, gatimit, magazinimit të mallrave ushqimorë, si dhe veshmbathjeve, tualetet, etj) evidentohen qartazi të ndryshuara: ka mungesë lagështire, pajisjet janë të reja, të mirëmbajtura;
- Përsa i takon verifikimit teknik (përpos verifikimit më këqyrje të lirë të realizuar nga inspektorët e KMD-së) të kushteve të magazinimit të mallrave ushqimorë, janë mbajtur akte verifikimi përkatëse (procesverbalë konstatimi) të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) si dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), rezulton se, përse i takon kushteve të magazinimit të produkteve ushqimore, lagështira është eliminuar plotësisht dhe gjendaj e magazinimit të tyre është në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Kabinetet e punës si “Logopedia”, “Fizioterapia”, të domosdoshme për trajtimin e personave rezident të Qendrës, janë të pajisura me bazën e nevojshme didaktike e materiale, të vëna në efikasitet të tyre;
- Gjithashtu janë parashikuar fonde të posaçme për mjetet didaktike të terapive të zhvillimit dhe të atelieve të punës në Qendër, edhe për vitin në vijim (bazuar në shkresën me nr. 58 prot., datë 07.04.2023 “Plan-Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, të QZHPAK Vlorë-zëri “Investime” për vitin 2023 janë parashikuar 2.000.000 lekë).

*Referuar akt-konsatimeve të kryera nga AKU, respektivisht:*

- Procesverbalit të inspektimit me nr. AKU-VL-2023-000515-2, datë 07.04.2023, të AKU/ Dega Rajonale e Qarkut Vlorë;
- Vendimit Përfundimtar të Inspektimit me Nr. AKU-VL-2023-000515-5, datë 07.04.2023, të AKU/ Dega Rajonale e Qarkut Vlorë, lidhur me inspektimin e realizuar prej tyre në subjektin QZHPAK Vlorë, në datën 07.04.2023, është konkluduar në vendimin përfundimtar se: *“Bazuar në indicien e dërguar me e-mail në datë 05.04.2023 në DRAKU Vlorë, në lidhje me njoftimin e bërë në media për subjektin QZHPAK Vlorë, u krye procedura e inspektimit në ambientet e magazinës dhe në ambientet e gatimit, si dhe*



verifikimi i dokumentacionit. Nga inspektimi rezultoi se subjekti plotëson kërkesat strukturore: strukturë beton arme, e përshtatshme, hapësira e planimetri të përshtatshme. Subjekti është i pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për një kuzhinë optimale (frigoriferë, sobë gatimi, raftë, lavamanë, etj). Plotëson kërkesat dokumentare. Subjekti është i pajisur me librezë shëndeti, palnin DDD dhe analizën bakteriale të ujit, fatura tatimore, fletë-analiza dhe certifikata veterinare për lëndët e para, gjurmueshmëri edhe regjistra të temperaturave për frigoriferët. Kushte higjeno-sanitare shumë të mira. Proceset e magazinimit, të përpunimit, pjekjes, zierjes dhe shpërndarjes së ushqimit të përshtatshme. Nuk u evidentua prezencë lagështire në asnjë nga ambientet. Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSh”, nenin 47, të tij, inspektimi i kryer është i plotë dhe gjatë inspektimit nuk u konstatuan shkelje ligjore.”

- Vendimit Përfundimtar të Inspektimit me nr. AKU-VL-2023-001203-5, dhe nr. AKU-VL-2023-001203-2, datë 14.07.2023, të AKU/ Dega Rajonale e Qarkut Vlorë, lidhur me inspektimin e realizuar prej tyre në subjektin QZHPAK Vlorë, në datën 14.07.2023, është konkluduar në vendimin përfundimtar se, në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSh”, nenin 47, të tij, inspektimi i kryer është i plotë dhe gjatë inspektimit nuk u konstatuan shkelje ligjore.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, bazuar në Listë-Verifikimin e Inspektimit të Përgjithshëm të Higjenës për Stabilimentet e Ushqimit dhe Operatorët e Biznesit Ushqimorë, me Nr. AKU-VL-2023-001203-2/1, datë 14.07.2023, ka konstatuar se nga QZHPAK Vlorë, nuk është konstatuar asnjë shkelje e ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSh”, të ndryshuar, ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjenës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimorë”.

*Referuar akt-konstatimeve të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor/Degës Rajonale të Qarkut Vlorë (DRISHSH Vlorë), respektivisht, Vendimit Përfundimtar të Inspektimit me Nr. ISHSH-VL-2023-000079-5, datë 24.04.2023, të ISHSH/ Dega Rajonale e Qarkut Vlorë, lidhur me inspektimin e realizuar prej tyre në subjektin QZHPAK Vlorë, në datën 24.04.2023, është konkluduar në vendimin përfundimtar se, gjatë inspektimit nuk u konstatuan shkelje ligjore.*

*Referuar akt-konstatimeve të Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqëqyrjes së Tregut (ISHMT), Drejtoria Qendrore, respektivisht:*

- Procesverbalit të inspektimit me nr. ISHMT-DQ-2023-001533-2, datë 25.07.2023, të ISHMT/ Drejtoria Qendrore, dhe Listë Verifikimit për ashensorët, me nr. ISHMT-DO-2023-0015333-2/1, datë 25.07.2023, të ISHMT-së, u konkludua se nuk janë konstatuar shkelje ligjore.



- Vendimit Përfundimtar të Inspektimit me nr. ISHMT-DQ-2023-001533-5, datë 25.07.2023, të ISHMT/ Drejtoria Qendrore, lidhur me inspektimin e realizuar prej tyre në subjektin QZHPAK Vlorë, në datën 25.07.2023, është konkluduar në vendimin përfundimtar se, gjatë inspektimit nuk u konstatuan shkelje të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar dhe ligjir nr. 10480/2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

*Referuar akt-inspektimit të kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHS), pranë QZHPAK Vlorë, me datë 22.06.2023, rezulton se:*

- Objektivat e këtij inspektimi ishin:
  - Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të përfituesve;
  - Aksesueshmëria, siguria, mirëqenia dhe planet e përkujdesit të përfituesve;
  - Dokumentacioni, kriteret dhe procedurat e pranimit të përfituesve;
  - Dokumentacioni i stafit të Qendrës;
  - Kushtet higjeno-sanitare të Qendrës.

*Nga kontrolli i ushtruar për zbatimin e standardeve të përkujdesit, bazuar në VKM nr. 822, datë 06.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale”, ndër të tjera, rezultoi se:*

- Nga kontrolli i regjistrave, evidencave dhe dosjeve të përfituesve në Qendër, për çdo resident (përfitues) është hapur dosja e tij personale, e cila përmban: dokumentacionin e pranimit, Vendimin e KMCAP, vendimin e pranimit, certifikatë personale e fëmijës, deklaratë noteriale, procesverbalin e firmosur nga ekipi multidisiplinar për pranimin e përfituesit në institucion. (Pranimet janë bërë sipas vendimit të Komisionit përkatës të SHSSH, në 26 raste dhe në 4 raste janë pranuar me vendimin e Komisionit përkatës në Vlorë. Akomodimi i fundit është bërë në vitin 2018)
- Vlerësimi dhe plani individual i përfituesit është i mbartur ndër vite. Planet individuale janë një vjeçare, dhe specialistët e ekipit multidisiplinar janë: mjeku, punonjësja sociale, logopedisti, fizioterapisti dhe specialist okupacional. Specialistët terapistë administrojnë fashikujt përkatës të dosjes së përfituesit, sipas specialitetit të tyre.
- Në drejtim të edukimit, arsimimit, integritimit, fëmijët marrin, bazuar në planin individual, terapi individuale (fizioterapi, logopedi, terapi zhvillimi) si dhe terapi në grup, si orë edukative mësimore, terapi okupacionale, aktivitete kreative, etj.
- Terapistët, edukatori dhe kujdestarët kanë plane mujore dhe ditare për orët dhe punën që zhvillojnë. Përveç programit edukativ në Qendër, 5 fëmijë rezultoi të ndjekin procesin mësimor në shkollën speciale. Gjithashtu, një vajzë rezultoi se ndjek kurs privat pikturë, i ofruar falas në sajë të bashkëpunimit të Qendrës me subjektin privat që e ofron këtë shërbim.

*Lidhur me kujdesin shëndetësor, u konstatua që:*

- Në përbërje të stafit të përkujdesjes, Qendra ka një mjek, punësuar me kohë të pjesshme, i cili ofron kontroll rutinë dhe kujdes shëndetësor, si dhe rekomandime për ekzaminime plotësuese apo rekomandime për stafin përkatës, për secalin fëmijë;
- Për rastet e nevojshme për ekzaminime, për ndërhyrje e terapi të specializuara, fëmijët marrin shërbimin përkatës në Qendrat publike të kujdesit spitalor;
- Në Qendër funksionin dhoma e infermierisë, e cila u konstatua e kompletuar me mjete pune dhe orendi për ruajtjen e medikamenteve. U verifikuan regjistrat përkatës të Infermieres, në të cilin rezultuan të plotësuarat: datat dhe recetat e kontrolleve, oraret dhe sasia e medikamenteve të dhëna.

*Jeta socializuese në Qendër rezulton e programuar. Bazuar në planet mujore janë programuar aktivitete relaksuese dhe argetuese në mjediset e brendshme të Qendrës, por edhe jashtë saj. Qendra zhvillon aktivitete të ndryshme si: festime të festive kombëtare, aktivitete në ditët për të drejtat për PAK, ditëlindjet e rezidentëve, etj.*

*Në lidhje me trajtimin ushqimor, në QZHPAK Vlorë rezulton të gatuhet me menu javore, të programuar dhe të konsultuar. Gjithashtu, nga kontrolli rezultoi që Qendra ka krijuar kushte të mira të magazinimit dhe të përgatitjes së ushqimeve.*

*Nga kontrolli mbi aksesueshmërinë, akomodimin dhe kushtet higjeno-sanitare, rezultoi që:*

- QZHPAK Vlorë është e aksesueshme, pa barriera fizike dhe e pajisur në mjediset e brendshme me aksesore që ndihmojnë përfituesit (veçanërisht në tualete), por u konstatua që ashensori nuk është funksional. Për këtë, u rekomandua Qendra, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, në cilësinë e Administratorit të Qendrës, të marrin masa për riparimin dhe vënien në funksion të ashensorit;
- Akomodimi i përfituesve është bërë në Katin e dytë, i cili ka 12 dhoma fjetjeje. Dhomat kanë hapësirë të bollshme, dhe sipas rastit e specifikes, akomodimi është maksimumi 3 përfitues në dhomë.
- Godina ofron hapësira të jashtme shumë funksionale dhe të sigurta, për aktivitete dhe relaksim, si në katin e I-rë, në të cilin janë përqendruar kabinetet e terapisë, po ashtu edhe në katin e II-të, ku përveç dhomave të fjetjes, janë edhe 2 klasa atelie dhe dy mjedise ndenjeje/ngrënie (minikuzhina);
- Në tërësi ambientet janë të kompletuara dhe rezultuan të pastra nga ana higjeno-sanitare.

*Për ofrimin e shërbimit dhe administrimin e institucionit, Qendra ka në tërësi një staf/strukturë prej 32 punonjësish me kohë të plotë dhe një punonjës (mjek) me kohë të pjesshme.*

- Përsa i përket figurave profesionale, të kërkura rezultoi që specialistët kanë arsimin e kërkuar si dhe janë të pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit (infirmieri, fizioterapisti dhe logopedi)

*Në lidhje me sigurinë e përfituesve (fëmijëve dhe të rinjve), sigurinë fizike dhe mbrojtjen e tyre nga abuzimet e ndryshme, rezultoi që:*

- Ambientet janë të sigurta, të rrethuara dhe të mbyllura me portë. Nuk mund të hysh në Qendër pa kontaktuar dhe i pashoqëruar nga stafi;
- Godina është e pajisur me portë dhe shkallë për dalje emergjente;
- Në Qendër ka afishime, informacione dhe numra kontaktesh lidhur me situatat e emergjencës. Ajo është e pajisur me mjete të mbrojtjes kundër zjarrit (fikëse). Gjithashtu, ka plane të evakuimit dhe sinjalistikës orientuese;
- Qendra ka afishime me informacione për të drejtat e fëmijëve, për të drejtat e personave me aftësi ndryshe, për llojet e abuzimit. Ekzistojnë format e referimit si dhe rregullat se si kryhet referimi, në rast të konstatimit apo dijenisë për dhunë, abuzim, neglizhim të një fëmije.

*Në lidhje me procedurat e ankimimit, rezultoi që në Qendër është e vendosur Kutia e Ankimimit dhe e shoqëruar me informacionet e nevojshme. U konstatua që hapja e Kutisë së Ankimimit bëhet me komision, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit nga Shërbimit Shtetëror Social, Zyra Rajonale Vlorë.*

*Në rubrikën e konkluzioneve të ISHPSHSH për QZHPAK Vlorë dhe Bashkinë Vlorë, ndër të tjera evidentohet, se: “Kjo Qendër vlerësohet për ndryshimet pozitive të bëra, në drejtim të përmirësimit të dukshëm të kushteve të akomodimit të përfituesve si dhe funksionimin e kabineteve terapeutike. Gjithashtu, vlerësohet për plotësimin e stafit me profesionistë si: logoped, fizioterapist, etj.”*

*Në përfundim të inspektimit të ushtruar në QZHPAK Vlorë, grupi i inspektorëve të ISHPSHSH, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit, ka lënë edhe rekomandimin sa i përket vënies në punë të ashensorit, duke cilësuar konkretisht: “QZHPAK Vlorë në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, në cilësinë e Administratorit të Qendrës, të marrin masa për riparimin e vënien në funksion të ashensorit.”*

*Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri vëren se, QZHPAK Vlorë, është një qendër rezidenciale e cila ofron shërbime 24 orë për rezidentët e saj/përfituesit, duke krijuar kushte dhe ambiente me karakteristika sa më afër atyre familjare. Në Qendër janë 30 rezidentë me handicap fizik, shqisor, motor, sensor, mendor, të cilët përfitojnë nga shërbimet e ofruara, nga ku 12 janë vajza dhe 18 djem. Pjesa më e madhe e përfituesve janë të braktisur ose kanë ardhur nga shtëpitë*

e fëmijës. Diagnozat e tyre variojnë: autizëm, çrregullime të sjelljes, prapambetje e lehtë/e moderuar/e thellë mendore, morbus down, etj.

Komisioneri, nisur nga verifikimet e bëra nëpërmjet inspektimit të realizuar nga inspektorët e tij, duke konsideruar edhe inspektimet e konkluzionet e dala nga institucionet përgjegjëse, kompetente për verifikimin e kushteve teknike, fizike e higjeno-sanitare etj, të ambienteve të Godinës dhe kushteve të tjera, pas momentit të inicimit të shqyrtimit kryesisht të çështjes së verifikimit të kushteve të jetesës së rezidentëve (PAK) të kësaj Qendre, si dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, evidenton se:

- Kushtet e akomodimit e trajtimit të rezidentëve me PAK, përfitueve të saj, janë përmirësuar dukshëm (sikurse janë specifikuar me hollësi më sipër në vendim), duke krijuar karakteristikat e një ambienti shumë familjar, në përmbushje të politikave sociale si dhe në shërbim të qëllimit të Qendrës, lidhur me: mirërritjen, kujdesin shëndetësor dhe social, sigurimin e një cilësie të mirë jetese, edukimin, trajtimin psiko-social për rezidentët të cilët marrin shërbimin në këtë Qendër.

Shërbimet e ofruara nga Qendra, si një institucion shtetëror, me natyrë sociale dhe rehabilituese, janë në dy nivele:

- Në nivelin e specialistit – përfaqësuar nga: punonjësi social, logopedi, infermieri, fizioterapisti dhe edukatorët metodistë dhe specila, të cilët mbulojnë nivelin edukativ-pedagogjik;
- Në nivelin e shërbimit – përfaqësuar nga: kuzhinierët, kujdestarët e natës, sanitaret, magazinieri, lavantieri, etj.

Forma kryesore e organizimit dhe funksionimit të Qendrës është ajo e procesit rehabilitues dhe zhvillues nëpërmjet programave të edukimit special për aftësimin e zhvillimin e rezidentëve në fushat kryesore që janë: autonomia personale, komunikimi, shoqërizimi, integrimi social, psiko-motoriciteti, zhvillimi i shqisave, etj.

Shërbimet e ofruara janë të shumëllojshme, duke cituar këtu: terapinë e zhvillimit, terapinë e gjuhës, terapi okupacionale apo shërbime fizioterapie. Rezidentët janë ndarë në klasa ku ofrohet mësimdhënie nga stafi edukativ-pedagogjik. Shërbime këto të ofruara nga stafi multidisiplinar i Qendrës, ku futen: punonjësi social, logopedi, infermieri, fizioterapisti, edukatorët metodistë dhe specialist, etj.

Komisioneri vëren se, Qendra ofron dhe shërbime të tjera si: ofrimi i ushqimit, përkujdesja personale, ambientale, higjena, veshmbathja, etj.

Ambientet e shërbimit në Qendër janë të ndara dhe të vendosura në dy katet e saj:

- Në katin e I-rë, kryesisht janë vendosur ambientet e shërbimit të tilla si: zyrat e administratës, kuzhina, mensa, kabineti i fizioterapisë, kabineti i logopedisë, punonjësi social, atelietë, tualetet, dy magazinat, etj.

- Në katin e II-të, kryesisht janë të vendosura dhomat e gjumit të rezidentëve, infermiera, sala e personelit, atelietë e shërbimit, tualetet, etj.

Të gjitha këto ambiente janë në parametrat normal të tyre sa i përket: kushteve fizike, hapësirave, ndriçimit, ngrohjes, arredimit të nevojshëm, sigurisë, pastërtisë dhe krijimit të një fryme e ambienti shumë familjar e të rehatshëm për rezidentët.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur.

Materializimi i shumë të drejtave për individët, bëhet pikërisht nëpërmjet hartimit dhe miratimit të ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e qeverisë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, QZHPAK Vlorë ka reaguar pozitivisht, gjatë shqyrtimit të kësaj problematike nga Komisioneri, duke marrë masa konkrete dhe duke bërë ndërhyrje shumë efektive, lidhur me përmirësimin e dukshëm të kushteve fizike, dhe jo vetëm, të godinës e ambienteve të brendshme e logjistikës së tyre, në krahasim me pamjet e transmetuara në emisionin Fiks Fare” të datës 29.03.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, mbi të cilat mori indicien për të hetuar kryesisht këtë çështje.

Theksojmë se, Komisioneri ka patur dhe ka vazhdimisht në vëmendje, faktin që të gjitha strukturat shtetërore të ngarkuara për monitorimin e funksionimit e ushtrimit të detyrës së qendrave rezidenciale në Shqipëri, në përputhje me standardet ligjore e sociale, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, si dhe parimit të trajtimit të barabartë, pa diskriminim e me dinjitet të personave me aftësi të kufizuara, duhet të tregojnë një kujdes të shtuar dhe tejet të veçantë.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave që i jepen prej ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar me një ndjeshmëri të veçantë rastet e ngjashme, që lidhen me trajtimin e kësaj kategorie të veçantë personash.

Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ndaj të cilit ka nisur procedura hetimore ka reaguar në mënyrë shumë efektive; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës së rezidentëve të QZHPAK Vlorë, lidhur me kushtet fizike të Godinës ku ata marrin shërbimin 24 orë, ambienteve të përshtatshme për një jetesë dinjitoze dhe në përputhje me nevojat e specifikat e tyre.

Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të QZHPAK Vlorë, lidhur me reagimin e dukshëm konkret e shumë efektiv.

Neni 33, pika 9 e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se procedura administrative e nisur kryesisht bazuar në Urdhrin nr. 56, datë 11.04.2023, lidhur me monitorimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar, në ambientet e godinës së Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, Vlorë, në Bashkinë Vlorë, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Komisioneri, vëren se, qëllimi për të cilin dhe është iniciuar procedura hetimore, është përmbushur gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes pranë KMD-së.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet e ndryshimit të rrethanave: faktike dhe ligjore, është përmbushur kërkesa e Komisionerit për përmirësimin e kushteve të ambienteve të Qendrës ku jetojnë 30 rezidentë/përfitues të shërbimit të saj.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”*.

Për sa më sipër, bazuar në verifikimet e bëra lidhur me kushtet aktuale të godinës së QZHPAK Vlorë, ku aktualisht marrin shërbim 24 orësh 31 rezidentë; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesat e synuara për tu realizuar janë plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim.

Njëherësh, Komisioneri, thekson se, pavarësisht masave konkrete, të dukshme dhe shumë pozitive lidhur me përmirësimin e kushteve (fizike, logjistike, higjeno-sanitare, etj) të të gjitha ambienteve të godinës së Qendrës, mbetet ende një problematikë për t’u zgjidhur nga QZHPAK

Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë: vënia në funksionalitet e ashensorit të kësaj Godine, shërbim i cili në kuadër të aksesueshmërisë për PAK, duhet të jetë në përputhje me parashikimet e VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e haësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, (përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara) duhet të sigurohet që t’i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara teknike dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushen, sikurse është në rastin e vënies në funksionalitet të ashensorit të Qendrës, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson gadishmërinë e vullnetin e treguar nga përfaqësuesit e QZHPAK Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, lidhur me marrjen e masave për realizimin e një ndërhyrje e tillë, në përputhje me kriteret teknike të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM-të respektive. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në shërbime e infrastrukturë në baza të barabarta me të tjerët.

Në bazë të nenit 23, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, përcaktohen funksionet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, duke parashikuar shprehimisht në pikën 4, të këtij neni, se, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre.

Bashkia është një entitet që ekziston e funksionon si një tërësi organizmesh e strukturash të veçanta të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën në funksion të saj. Në këtë kuadër, për realizimin



e saktë të funksioneve dhe përgjegjësi të Bashkisë së Vlorës, të gjitha strukturat e administratës së Bashkisë dhe strukturat në varësi të saj, ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, *për* dhe *në* emër të Bashkisë.

Sa më sipër, rezulton se, (pavarësisht detyrave e përgjegjësi specifike të strukturave të veçanta brenda entitetit të Bashkisë) është në përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore, Bashkisë Vlorë dhe QZHPAK Vlorë, (e cila ndodhet në varësi të saj) që në bashkëpunim e bashkëkoordinim me njëra-tjetrën, të dyja strukturat, në rastin në fjalë, të sigurojnë aksesueshmërinë lidhur me vënien në eficientë të funksionimit të ashensorit në Qendër.

Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se, përmbushja e standardeve teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, është përgjegjësi e drejtëpërdrejtë dhe një detyrim ligjor për t'u përmbushur nga ana e QZHPAK Vlorë në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë.

**Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson të gjithë hapat e ndjekur për plotësimin e sa më sipër, si dhe, rekomandon vlerësimin me prioritet (duke qenë se QZHPAK VLORË është në proces realizimi) dhe realizimin sa më parë, të vënies në funksionalitet të ashensorit të godinës, konform përcaktimeve ligjore respektive.**

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronjat c) e ë<sup>19</sup>), nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

---

<sup>19</sup> “1. Komisioneri ka kompetencë:.....c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

.....

ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente...”

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ndjekjes kryesisht të çështjes së monitorimit të kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar, në ambientet e godinës së Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, (QZHPAK) Vlorë, bazuar në Urdhrin nr. 56, datë 11.04.2023, të Komisionerit, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. QZHPAK Vlorë në bashkëpunim me Bashkinë e Vlorës, në përfundim të vënies në funksion të ashensorit në godinën e Qendrës, të informojnë Komisionerin lidhur me sa më sipër, si dhe të depozitojnë pranë KMD-së dokumentacionin përkatës të marrjes në dorëzim të tij (të përmbushjes së kritereve të kërkuara teknike të tij), si dhe fotot ilustruese.
3. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijani, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra (si dhe afatin e realizimit) për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.
4. Rekomandimin e Bashkisë Vlorë dhe të Shërbimit Social Shtetëror, që nëpërmjet strukturave përkatëse përgjegjëse të tyre, të ushtrojnë kontrolle periodike monitorimi, lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë së qendrave rezidenciale për grupet vulnerabël, (kryesisht për personat me aftësi të kufizuara), lidhur me respektimin e të drejtave të rezidentëve, parashikuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Punoi: R. Hoxha  
Rishikoi: A. Xhindi  
Konfirmoi: V. Bushati  
Datë: 13.11.2023